



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 28.10.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **27.10.2025**, të parashtruar nga OE **AKTIV SH.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RITENDER “Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Emergjente në QKUK – vazhdim projekti”** me nr. prokurimi 206-25-8662-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE **AKTIV SH.P.K** e dt. 27.10.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **RITENDER “Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Emergjente në QKUK – vazhdim projekti”** me nr. prokurimi 206-25-8662-5-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 24.09.2025;
2. **Vërtetohet**, Njoftimi për Kontratë i datës 24.09.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE **AKTIV SH.P.K** me datën 27.10.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RITENDER “Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Emergjente në QKUK – vazhdim projekti”** me nr. prokurimi 206-25-8662-5-1-1. Autoriteti Kontraktues me datë 28.10.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
RREGULLORJA NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK
Neni 4.3 i Rregullores 001/2022 per Prokurim Publik
Neni 17.17 i Rregullores 001/2022 per Prokurim Publik

Pretendimet ankimore te OE ankues - Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Bazuar në Nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik
I nderuar Autoritet Kontraktues,
Ne, Emër të AKTIV SH.P.K, në cilësinë e pjesëmarrësit të interesuar në procedurën e prokurimit, duke u bazuar në Nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, parashtrojmë këtë kërkesë për rishqyrtim, për shkak të kufizimit të padrejtë të konkurrencës përmes kërkesave kualifikuese të vendosura në dosjen e tenderit.

Pretendimi I.

Tek kërkesat e kapacitetit ekonomik dhe financiar keni kërkuar: Kërkesa 2. OE ose GOE duhet të dëshmojë se ka mundësi financiare për financimin e kontratës, duhet të ketë të paktën një (1) milion Euro asete likuide financiare në llogarinë bankare ose të paktën një (1) milion Euro qasje të pakushtëzuar për kredi në dispozicion, për realizimin e kontratës (min. 51% të plotësohet nga lideri në rast të grupit). Dhe deshmite:

Dëshmia 2. Letër konfirmimi (Deklaratë) origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar për OE ose GOE, që vërteton disponueshmërinë e një (1) milion Euro në llogarinë bankare të kompanisë në dispozicion për këtë projekt, ose një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi të pakushtëzuar prej një (1) milion EUR, nëse është e nevojshme në emër të projektit. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.

Kufizimi që lideri i grupit duhet të ketë të paktën 51% të mbështetjes financiare është i panevojshëm dhe krijon pabarazi ndërmjet anëtarëve të grupit, duke mos marrë parasysh faktin që kapacitetet financiare mund të kombinohen nga të gjithë anëtarët së bashku për të siguruar realizimin e kontratës.

Një kërkesë e tillë nuk është në përputhje me parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit, të cilat janë themelore në procedurat e prokurimit publik.

Ajo kufizon mundësinë që grupet e operatorëve të organizohen në mënyrë fleksibile, duke ndarë përgjegjësitë dhe kapacitetet sipas natyrës së projektit, jo sipas një përqindjeje të caktuar financiare.

Prandaj kërkojmë që kërkesa të largohet në pjesën që përcakton përqindjen minimale të liderit (51%), dhe të lejohet që mbështetja financiare qoftë përmes aseteve likuide apo qasjes në kredi të dëshmohet nga cilido anëtar i grupit.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kërkesa 2. OE ose GOE duhet të dëshmojë se ka mundësi financiare për financimin e kontratës, duhet të ketë të paktën një (1) milion Euro asete likuide financiare në llogarinë bankare ose të paktën një (1) milion Euro qasje të pakushtëzuar për kredi në dispozicion, për realizimin e kontratës (min. 51% të plotësohet nga lideri në rast të grupit).

Dëshmia 2. Letër konfirmimi (Deklaratë) origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar për OE ose GOE, që vërteton disponueshmërinë e një (1) milion Euro në llogarinë bankare të kompanisë në dispozicion për këtë projekt, ose një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi të pakushtëzuar prej një (1) milion EUR, nëse është e nevojshme në emër të projektit. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.

Ne, si Operator Ekonomik, në lidhje me RITENDER "Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Emergjente në QKUK – vazhdim projekti", paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim mbi bazën e shqetësimeve të ngritura më poshtë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Arsyeja e kërkesës:

Kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit paraqesin kufizim të hapur të konkurrencës, si dhe eliminim të Operatorëve Ekonomikë që posedojnë kapacitete teknike, por që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara, të cilat duket se janë formuluar në mënyrë të tillë që të favorizojnë një OE të caktuar.

Në këtë mënyrë, është cenuar parimi i konkurrencës së drejtë dhe të barabartë, i garantuar në:

- Nenin 17.17 të Rregullores Nr. 001/2022, i cili përcakton se dosja e tenderit nuk duhet:
 - o a. të kufizojë konkurrencën në mesin e OE, ose
 - o b. të diskriminojë ose të favorizojë një ose më shumë OE.

Për më tepër, kërkesat e aplikueshme në këtë procedurë janë të tilla që mund të plotësohen vetëm nga një operator i caktuar, duke vënë në dyshim objektivitetin dhe paanshmërinë e procesit të prokurimit.

Kërkesa jonë:

Në përputhje me Nenin 53.7 të LPP-së, kërkojmë që:

- Të rishqyrtoni dhe përmirësoni dokumentet e tenderit;
- Të largoni kriteret që kufizojnë konkurrencën dhe favorizojnë një OE të caktuar;

- Të siguroheni që dokumentet e tenderit janë në përputhje me parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë.

Neni 53

Sigurimi i Informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

7. Nëse, në një aktivitet të prokurimit që përfshin përdorimin e procedurave të hapura, të kufizuara ose konkurruese me negociata, autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik, dhe afati në të cilin informatat e tilla jepen është më i shkurtër se dhjetë (10) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoritetit kontraktues do ti zgjatet afati i tillë për ti dhënë operatorëve ekonomik së paku dhjetë (10) ditë nga dita në të cilën informatat përkatëse jepen për ti dorëzuar tenderët e tyre. Nëse një operator ekonomik ka dorëzuar një tender, operatorit të tillë ekonomik do ti lejohet që të dorëzojë një përmirësim për tenderin përkatës, por përmirësimi i tillë kufizohet vetëm në ndryshimet që janë të lidhura me informatat e tilla të arsyeshme sqaruese ose shtesë.

Gjithashtu ju NUK e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Ju si Autoritet Kontraktues duhet të keni në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues që të nxjerrin:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE AKTIV SH.P.K.

OBLIGOHET AK- Ministria e Shëndetësisë të largoj kërkesat kundërligjore, të aplikoni dispozitat e Nenit 53.7 të LPP-së si dhe duke korrigjuar versionon e fundit të Dosjes së Tenderit në të cilën duhet të identifikohen ndryshimet konform korrigjimeve të bëra.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar Kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimet e juaja ankimore janë të pa bazuara.

Kërkesa nr. 2 të kapaciteti ekonomik dhe financiar në DT, është plotësisht e drejtë dhe jo diskriminuese. Kjo kërkesë është e bazuar në UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, shih dispoziten faqe 29:

iii. Shënim për kërkesat e gjendjes ekonomike dhe financiare (neni 68 i LPP-se):

a. Raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka

Në rast të kontratave me vlerë të madhe, kur Operatori ekonomik ka për të financuar zbatimin e kontratës, është e dobishme për të kërkuar shumë të caktuar të likuiditetit ose për të njëjtën vlerë shënim premtues për kredi. Mund të sigurojë se Operatori ekonomik do të marrë kredi nga banka në rast nevojë, ose kompania ka të holla (cash) dhe është në gjendje të zbatojë kontratën pa kredi. Për më tepër, banka mund të vërtetojë se Operatori ekonomik paguan rregullisht pa vonësë shpengimin e tij të kreditit, e cila gjithashtu është një garanci se Operatori ekonomik ka sfond solid financiar.

Shembull:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 500.000 euro asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 500.000 euro qasje për kredi në dispozicion.

Dëshmia dokumentare 1. Deklarata nga banka që vërteton disponueshmërinë e 500.000 euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi prej 500.000 EUR, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.

Edhe kërkesa për 51% të plotësimin nga lideri i GOE është e specifikuar në UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, shih dispoziten faqe 33:

- Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-së. AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimin të kërkesave për gjendjen ekonomike dhe financiare nga lideri i grupit të OE.

Shembull:

Qarkullimi minimal i kërkuar nga AK është 2,000,000 euro dhe AK, mund të përcaktojë në Njoftimin për kontratë se lideri i grupit preferohet të përmbushë së paku 51% e këtij qarkullimi minimal.

Vlera e kerkuar prej nje (1) milion qasje ne kredi eshte mjaft e ulet dhe aspak diskriminuese, krahasuar me vleren e madhe te ketij projekti. Aktiviteti eshte ritender, ndersa nese nuk e dini, ju informojme se ne tenderimin heren e pare kjo kerkese ka qene kater (4) milion euro (tenderi me nr. 206-23-14371-5-1-1).

Eshte praktike jo e mire atakimi i aktivitetit ne menyre direkte me Kerkese per Rishqyrtim dhe pa e shfrytezu mundesine e Sqarimeve Shtese, meqense shkakton pengese me pezullim te pa nevojshem te procedures, per çeshtje qe kane mund te trajtohen me sqarime ne kohen e duhur.

Ju si OE keni mundur qe keto pretendime ti adresoni permes Sqarimeve Shtese ne kohen e percaktuar per pyetje sqaruese dhe ne do u pergjigjeshim me sqarime shtesë si gjithe OE tjere.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit